

Nr. Prot. 428 Dt. 27/09/2024**KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE NË NIVELIN BACHELOR DHE MASTER, PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025**

Këshilli Akademik, në përputhje me nenin 15 të Statutit të Përkohshëm të Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM), dhe bazuar në Rregulloren e Punës dhe Funksionit të Këshillit Akademik të datës 27.02.2024, me konfirmim online (email) më 25.06.2024, miraton propozimet e njësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2024/25, si dhe miraton kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet Bachelor dhe Master. Propozimet për numrin e studentëve për regjistrim për vitin akademik 2024/25, janë miratuar edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Kolegji IBCM, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2024/2025, do të regjistrojë 492 studentë në studimet e rregullta, prej të cilëve 360 studentë në studimet Bachelor dhe 132 studentë në studimet Master.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI-it, Kolegji IBCM do të regjistrojë deri në 40 %, përkatësisht deri 196 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë, në programe të ndryshme studimi.
3. Në Kolegji, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI-i, mund të pranohen deri në 3% përkatësisht deri 15 kandidatë të cilët kanë lindur në vendet e rajonit jashtë Kosovës (Shtetas të Huaj). Ndërsa kandidatët të cilët shkollimin e mesëm apo Bachelor e kanë mbaruar jashtë Republikës së Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Mbi bazë të konsideratave humane, Kolegji IBCM rezervon të drejtën e pranimin të kandidatëve me nevoja të veçanta.
5. Kolegji nuk do të mundësojë kritere lehtësuese për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
6. Të drejtë pranimi në Kolegjin IBCM kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm apo atë Bachelor e kanë përfunduar në njërin prej institucioneve publike apo private të licencuara dhe akredituara (për arismin e lartë) në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
7. Në Kolegji mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.

8. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët nuk e kanë nënshtetësinë e Republikës së Kosovës.
9. Për kandidatët që shkollimin e mesëm apo Baçelor e kanë përfunduar jashtë Republikës së Kosovës, vendimi për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret nga MASHTI-i.
10. Kolegji do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën angleze.
11. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
12. Për aplikim në studimet Master, nostrifikimi i diplomave në studimet Baçelor të fituara jashtë Republikës së Kosovës bëhet ga MASHTI.
13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Kolegjit IBCM nuk kanë të drejtë konkurrimi në programin tjetër studimi në Kolegji pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. Kandidatët për pranim si studentë të Kolegjit IBCM në vitin akademik 2024/25 mund të konkurrojnë në më shumë se në një fakultet apo program, por në rast se pranohen në më shumë se një program, kanë të drejtë të përzgjedhin vetëm njërin program për regjistrim në studime.

## II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve në studimet Baçelor për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
  - 1.1. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës, numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - 1.1.1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 60 pikë; dhe
    - 1.1.2. Suksesi në provim pranues deri në 40 pikë.
  - 1.2. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës, numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
    - 1.2.1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;

- 1.2.2. Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe,
- 1.2.3. Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. Përzgjedhja e kandidatëve në studimet Master do të bëhet sipas kritereve si në vijim:
  - 2.1.1. Suksesi në studimet Baçelor deri në 60 pikë; dhe
  - 2.1.2. Suksesi në provim pranues deri në 40 pikë.
3. Provimi pranues hartohet me 100 pikë (ku sistemi sipas aplikuesit i konverton në 40 pikë)
4. Të drejtë pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 60% nga numri i pikëve të parapara në provimin pranues.
5. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 60% nga numri i pikëve të parapara në provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
6. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 1- 4 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kritereve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë pranimi kanë vetëm ata studentë që arrijnë së paku 60% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues, vendet e lira të cilat mbesin nga pika 2 dhe 3 nuk zëvendësohen.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës së mesme.

### III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve Baçelor, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet prej 27.06.2024 deri më 19.07.2024, nga ora 09:00-16:00 (ditë pune), tek zyra e shërbimit për studentë, në cilindo kampus të Kolegjit IBCM.
2. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
3. Me rastin e aplikimit për studimet Baçelor, kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:
  - 3.1. Ekstraktin e lindjes (origjinale, jo më të vjetër se gjashtë muaj);

- 3.2. Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (originale, të noterizuara ose dublikatë);
  - 3.3. Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme dhe dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (originale, të noterizuar ose dublikatë);
  - 3.4. Kopjen e letërnjoftimit;
  - 3.5. Fletë aplikacionin, i cili mund të shkarkohet në webfaqen e Kolegjit IBCM, apo të merret në kopje fizike në Kolegj.
  - 3.6. Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit, për kandidatët që shkollimin e mesëm e kanë të përfunduar jashtë vendit (originale, të noterizuara ose dublikatë).
4. Me rastin e aplikimit për studimet Master, kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:
    - 4.1. Ekstraktin e lindjes (originale, jo më të vjetër se gjashtë muaj);
    - 4.2. Diplomën e kryerjes së studimeve Baçelor (originale, të noterizuara ose dublikatë);
    - 4.3. Çertifikaten e notave nga studimet Baçelor (originale, të noterizuara ose dublikatë);
    - 4.4. Kopjen e letërnjoftimit;
    - 4.5. Fletë aplikacionin, i cili mund të shkarkohet në webfaqen e Kolegjit IBCM, apo të merret në kopje fizike në Kolegj.
    - 4.6. Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit, për kandidatët që studimet Baçelor i kanë të përfunduar jashtë vendit (originale, të noterizuara ose dublikatë);
  5. Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në paragrafin 3, respektivish 4, të kësaj pike t'i dorëzojnë në zyrën e studentëve në Kolegjin IBCM.
  6. Të gjithë kandidatët do të nënshtrohen provimit pranues në testin e gjuhës angleze.
  7. Numri i studentëve të rinjë të propozuar sipas fakulteteve dhe programeve studimore:

<b>Fakulteti &amp; Programi</b>	<b>Numri i studentëve të propozuar</b>	<b>Numri i studentëve nga komuniteti joshumicë</b>	<b>Gjithësej</b>

<b>Fakulteti i Shkencave Sociale</b>			<b>232</b>
Administratë Publike dhe Mirëqenie (Baçelor)	60	40	100
Lidership dhe Menaxhim Ndërkombëtarë (Master)	80	52	132
<b>Fakulteti i Menaxhimit Ndërkombëtar të Biznesit</b>			<b>100</b>
Shitje dhe Menaxhim Ndërkombëtar (Baçelor)	60	40	100
<b>Fakulteti i Mjedisit, Teknologjisë dhe TI-së</b>			<b>160</b>
Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë (Baçelor)	60	40	100
TI e aplikuar (Baçelor)	36	24	60
<b>Gjithësej për gjitha programet</b>	<b>296</b>	<b>196</b>	<b>492</b>

8. Provimi pranues do të mbahet si në vijim:

8.1. Për kandidatët që aplikojnë në Fakultetin e Mjedisit, Teknologjisë dhe TI-së provimi pranues mbahet më 22.07.2024, duke filluar prej orës 10:00.

8.2. Për kandidatët që aplikojnë në Fakultetin e Menaxhimit Ndërkombëtar të Biznesit, dhe në Fakultetin e Shkencave Sociale, provimi pranues mbahet më 22.07.2024, duke filluar prej orës 14:00.

9. Shpallja e rezultateve për të gjithë fakultetet bëhet më 26.07.2024, në webfaqen e Kolegjit IBCM.

10. Kandidatët kanë të drejtë ankese pranë Kolegjit IBCM, tri ditë pune nga data e shpalljes së rezultateve, respektivisht deri më 31.07.2024.

Prof. Dr. Mihone Kerolli Mustafa

Kryesuese e Këshillit Akademik të Kolegjit IBCM

